



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:198851
Datë: 13.03.2024
Numri i dokumentit: 05445375

2023:198852

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në kontestin e paditësit N.S. nga fshati ..., Komuna Shtime, tani me vendbanim në Ferizaj, me numër personal, të cilin e përfaqëson Av. Xhavit Mahmuti nga Ferizaj, kundër të paditurit A.V. nga fshati, Komuna Shtime, tani me vendbanim në Shtime, me numër personal, të cilin e përfaqëson Av. Kemajl Ademaj nga Ferizaj, për shkak të pengim posedimit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, më dt. 13.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Refuzohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.S. nga fshati, Komuna Shtime, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se i padituri A.V. nga fshati, Komuna Shtime, ka kryer pengim posedimin me datën 03.09.2023 në dëm të paditësit, në atë mënyrë që i pa autorizuar dhe pa pëlqimin e paditësit duke filluar nga rruga e asfaltuar Shtime-Petrovë në anën perëndimore e deri në fund të paluajtshmërisë me nr. kad. ...-0 ZK Shtime në anën lindore e cila është pronë e paditësit ka vendosur shufrat metalike armaturë në distancë të caktuara, gurët me sip. prej 3m2, gypin e betonit në hyrje të paluajtshmërisë dhe duke ia ndaluar paditësit që më mos ta shfrytëzoj këtë pjesë të kësaj ngastre me pretendimin se edhe kjo është e tija, urdhërohet i padituri që në afatin prej 7 ditësh ta kthej në gjendjen e mëparshme të posedimit në atë mënyrë që të i hjek shufrat e metalit / armaturat dhe çdo gjë tjetër që ndodhet brenda paluajtshmërisë nga pika 1 e dispozitivit, në sipërfaqen prej 4573 m2 nën kanosje të përmbarimit me dhunë, i ndalohe të paditurit që në të ardhmen në të njëjtën mënyrë ose mënyra të ngjajshme ta pengoj paditësin në posedimin dhe shfrytëzimin e pasurisë nga pika I e këtij aktvendimi si dhe detyrohet të ja paguajë shpenzimet e përfaqësimit në lartësinë prej 1707.52€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga momenti i pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

II. Obligohet paditësi N.S. nga fshati ..., Komuna Shtime që të paditurit A.V. nga fshati ..., Komuna Shtime të ja paguajë në emër të shpenzimeve të procedurës, shumën në lartësi prej 644.00 euro (gjashtëqind e katërdhjetë e katër euro) dhe atë brenda afatit 7 (shtatë) ditor pas ditës së plotfuqishmërisë të këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi përmes të autorizuarit të tij av. Xhavit Mahmuti nga Ferizaj pranë kësaj gjykate më dt. 19.09.2023 ka parashtruar padi në të cilën ka theksuar se paluajtshmërinë nr. ...-0 në sipërfaqje prej 5573 m2 ZK Shtime babai i paditësit së bashku me të vëllaun e tij, këtu të paditurin, e kishin blerë për çmimin prej 2000.00 marka gjermane, dhe kanë hyrë në posedim dhe shfrytëzim të lirë të saj, paditësi për pjesën prej 4573 m2, ndërsa i padituri prej 1000 m2, i njëjti e kishte shfrytëzuar pronën e tij në mënyrë të qetë deri më dt. 03.09.2023 kur i padituri shkon tek daja i paditësit M.U. dhe ia tërheqë vërejtjen që të mos hyjë në brendi të ngastrës në pjesën e tij prej 10 ari ku edhe kishte vendosur shtylla të hekurit – armatura me pretendimin se edhe kjo pjesë e kufizuar tani i përket atij. Edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe në fjalë përfundimtare i autorizuari i paditësit, ka deklaruar se qëndron pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe pas shqyrtimit dhe administrimit të provave është vërtetuar se i padituri ka kryer aktin e pengimit të posedimit, kjo gjendje është vërtetuar përmes dëgjimit të dëshmitarëve M.U., Z.M., dhe Z.S, e po ashtu edhe përmes ekspertizës gjeodezike sipas përshkrimit në skicat është konstatuar prezenca e objekteve që i padituri i ka vendosur me qëllim të pengimit të shfrytëzimit të paluajtshmërisë nga ana e paditësit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

I padituri përmes të autorizuarit të tij av. Kemajl Ademaj nga Ferizaj, në përgjigjen në padi të dt. 05.10.2023, ka theksuar se i padituri para 22 vjetësh sipas marrëveshjes kontratës-procesverbalit të shkruar - joformal nga pronarët juridik të paluajtshmërisë e ka blerë ngastrën kadastrale Nr. ...-0 në sipërfaqje 5573 m2, ZK Shtime ashtu që me datë 06.12.2001 pronarit juridik të paluajtshmërisë në G. në prezencë të dëshmitarëve në emër të blerjes së paluajtshmërisë ia ka paguar çmimin e shitblerjes, thekson se paditësi N. është person i cili jeton dhe vepron në Zvicër dhe rrjedhimisht asnjëherë nuk ka qenë në posedim të paluajtshmërisë, paditësit i mungon legjitimiteti aktiv nga fakti se me asnjë provë nuk është dëshmuar se ai ka pasur ndonjëherë në posedim të paluajtshmërisë të përmendur në padi. Edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe në fjalë përfundimtare, i autorizuari i të paditurit, e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit,

me arsyetimin se përgjatë gjithë procedurës nuk ka arritur të vërtetohet se paditësi ka qenë ndonjëherë në posedim të parcelës kontestuese, e po ashtu paditësit i mungon legjitimiteti real aktiv pra e drejta e tij për të ngritur padi pasi që paditësi asnjëherë nuk ka qenë në posedim të parcelës objekt kontesti. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka administruar provat si në vijim: Certifikata e pronës e dt. 11.08.2023 e lëshuar nga ZK Shtime për parcelën kontestuese ...-0 ZK Shtime, Kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë e dt. 10.10.2022 LRP.nr..../22 ref.nr. .../2022 kopja e planit për parcelën kontestuse, ekspertiza gjeodezike të ekspertit M.L. të dt. 20.12.2023, padia për anulimin e kontratës dhe vërtetimin e drejtë së pronësisë të dt. 05.10.2023, aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj 2023:211376 i dt.09.10.2023.

Faktet

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartëcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se kërkespadija e paditësit është e pabazuar.

Nga leximi i certifikatës së pronës P-....-0 të datës 19.12.2023, gjykata ka konstatuar se ngastra kadastrale, e cila është objekt i këtij kontesti gjendet në vendin e quajtur "A.N." në Shtime, në sipërfaqe prej 5573 m², me kulturë shtëpi dhe oborr, ZK Shtime, evidentohet në emër të paditësit në pjesën ideale prej 1/1.

Nga leximi i kontratës për shitblerjen e paluajtshmërisë të datës 10.10.2022, e përpiluar nga Noteri Sh.S.T.në Shtime, vërtetohet se shitësi B.D. paluajtshmerinë nr. ...-0 ZK Shtime në vendin e quajtur "A.e.N." në sipërfaqe prej 5573 m², e regjistruar në certifikatën e pronës .../2022 datë 04.08.2022 të cilën paluajtshmeri ia shet paditësit në shumën prej 89,168.00€.

Nga leximi i ekspertizës gjeodezike të datës 20.12.2023 të punuar nga eksperti gjeodet Dr.sc. M.L. dhe nga dëgjimi i ekspertit në shqyrtimin gjyqësor, si dhe edhe nga seanca e daljes në vend

shiqim e datës 19.12.2023, është vërtetuar se dyert e shtëpisë në gjatësi prej 4.21 m janë të ndërtuara në rrugë publike "W.W." përkatësisht përball parcelave ...-0 dhe ...-0 ZK Shtime nga të cilat hin i padituri në shtëpinë e vet të ndërtuar brenda parcelave ...-0 ZK Shtime, rrethojat me shtylla betoni që është ngjitur me dyert e hymjes në drejtim jugor ka gjatësi prej 3.16m cili është i ndërtuar brenda rrugës publike "W.W.", shufra metalike të cilën në terren pohon i padituri që e ka vendosur gjendet në parcelën ...-0 ZK Shtime përkatësisht në pjesën perendimore të parcelës kontestuese përgjatë rrugës publike "W.W." sipërfaqja e gurëve të cilët gjenden brenda parcelës ...-0 ZK Shtime ka sipërfaqjen prej 3 m2, gypi i betonit me diametër prej 1m gjindet në rrugën publike "W.W." përkatësisht përball parcelës ...-0 ZK Shtime. Në pyetjen e gjyqtarit gjatë shqyrtimit gjyqësor, eksperti ishte përgjigjur: Ne terren e kemi gjetur vetëm një shufër metalike (kunj i hekurt) e cila gjendet ne pjesën perëndimore përkatësisht përgjatë rrugës publike "W.W.", gypi prej betoni e ka gjatësinë me diametër prej 1 metri i cili është i vendosur përballë parcelës ...-0-ZK Shtime, gypi prej betoni është i vendosur përgjatë rrugës publike "W.W." përkatësisht përballë parcelës ...-0-ZK Shtime, ne anën perëndimore te parcelës ...-0, kurse shufra metalike është e vendosur brenda parcelës ...-0, përkatësisht ne pjesën perëndimore te saj, brenda objektit te kontestit nuk kemi hasur elemente tjera te cilat kane bere pengimin e posedimit, përveç shufrës metalike dhe gypit prej betoni, dyert e hyrjes te cilat janë te vendosura përgjatë rrugës "W.W." shërbejnë për hyrje nga te cilat i padituri hyn ne shtëpinë e vet te ndërtuar brenda parcelës ...-0 si dhe për te hyr ne parcelën ...-0, kurse gjësende tjera ne parcelën ...-0 nuk kam mundur te identifikoj.

Nga leximi në kopjen e planit të datës 11.08.2023, të lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e Shtimës, gjykata e ka provuar faktin se në skicën e paraqitur gjendet ngastra kadastrale me numër P-...-0, të tipit parcelë, në sipërfaqe prej 5573 m2. ZK Shtime dhe se e njëjta evidentohet në emër të paditësit, më gjerësisht sikurse në këtë kopje të planit.

Nga leximi i padisë për anulimin e kontratës dhe vërtetimin e të drejtës së pronësisë të dt. 05.10.2023, me propozim për caktimin e masës së përkohshme, konstatohet se paditësi A.V. (këtu i padituri) ka ngritur padi në Gjykatën Themelore në Ferizaj kundër të paditurit N.S., B.D., M.D. dhe S.D., lidhur me anulimin e kontratës dhe vërtetimin e të drejtës së pronësisë për njësinë kadastrale Nr. ...-0, me sip. prej 5573 m2, ZK Shtime.

Nga leximi i aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj 2023:211376, i dt.09.10.2023, konstatohet se aprovet si i bazuar propozimi i paditësit – propozuesit A.V., ashtu që caktohet

masa e përkohshme e sigurisë me të cilën i ndalohe të paditurit – kundërpropozuesit N.S., që ta bëjë tjetërsimin, fshehjen apo ngarkimin e ngastrës kadastrale Nr. ...-0, me sipërfaqe prej 5573 m², ZK Shtime, deri në vendosjen në lidhje me çështjen kryesore, apo deri në ndonjë vendim tjetër të kësaj gjykate. Masa e përkohshme do të mbetet në fuqi deri në zgjidhjen definitive të çështjes kryesore apo deri në ndonjë vendim tjetër të gjykatës.

Nga leximi i deklaratave të dëshmitarëve M.U. i dëgjuar në seancën e dt. 30.01.2024 ka theksuar se që nga viti 2003 ose 2004 datën saktë nuk e di pronën objekt kontesti e kishte blerë babai i paditësit Z., thekson se paditësi pronën ia kishte besuar atij që ta punoj prej atëherë e deri më sot, e kishte mbjellë me grurë, ndërsa nga ajo pjesë 10 ari ishin ndarë A. të cilat dëshmitari thekson se nuk kishte hyrë në të për shkak se A. e kishte punuar vetë, e kujton datën 03.09.2023 kur kishte ardhur i padituri dhe i kishte thënë ‘ruaju kur ta shtini maqinën me korr misrin po e prish maqinën’, thekson se me të marrë vesh se i padituri i kishte vendosur disa shufra në arë, e kishte njoftuar Z. për shkak se prona ishte e tij dhe ky e kishte vetëm në shfrytëzim, po kemi biseduar me Z. dhe i kam thënë se A. ka qenë tek unë dhe më ka lajmëruar se plus 10 ari janë të mijat dhe se i ka vendosur armaturat në formë megje, kurse këto armatura unë nuk i kam parë personalisht me styë e mi, Z. më paguan diçka për këtë punë (400€ në muaj), pronën objekt kontesti ma ka dhënë për ta punuar Z. prej se e kanë blerë më shumë se 20 vite, dmth pronën e cila është objekt i kontestit unë e punoj pa pagesë për shkak se Z. ma ka dhënë për shfrytëzim si mik, këtë pronë unë e kam mbjellë sipas dëshirës time dhe jo sipas sugjerimeve të palëve në procedurë, edhe investimin edhe rendimentin (fitimin) i kam marrë vet.

Në dëshminë e këtij dëshmitari, të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse nuk kishin vërejtje.

Dëshmitari Z.M. kishte deklaruar se në pronën objekt kontesti ka të mbjellë kallamoq të cilën e ka mbjellë M.U., i cili e ka mbjellë me leje të Z. pronarit dhe atë për 24 vite (prej vitit 2000-2001), vetëm M. është duke e shfrytëzuar – mbjell këtë pronë, kurse a është duke u paguar unë nuk e di, edhe unë kam punuar në këtë pronë me eskavator ku e kam mbushur me dhe për afërsisht në vitin 2022-2023 me leje të Z., kurse A. përgjatë këtyre dy viteve kur unë kam punuar në këtë pronë nuk më ka penguar, i kujtohet ngjarja e datës 03.09.2023 ku pohon se kjo ditë ka qenë e shtune, kurse një ditë më përpara e M. e kishte njoftuar se A. i kishte thënë se nëse nuk e korr deri të dielën më nuk mund të hysh këtu, kurrë nuk ka hyrë nëpër arë dhe as nuk e di ku gjenden kunjat e hekurt në parcelën 0... dhe nuk e din se kush i ka vendosur ato.

Në dëshminë e këtij dëshmitari, i autorizuari i të paditurit kishte pjesërisht vërejtje.

Po ashtu ishte dëgjuar edhe dëshmitari Z.S i cili është babai i paditësit, ndërsa vëllau i të paditurit, i njëjti në këtë procedurë ka theksuar se po është e vërtetë se i padituri kishte vendosur shtyllat metalike dhe një gyp të betonit dhe disa gurë në pronën në fjalë, këtë pronë ka qenë duke e shfrytëzuar M. ndërsa pas vendosjes së këtyre shtyllave prona ka mbetur pa u shfrytëzuar. Në pjesën e majtë të arës gjendet një shtëpi dy katëshe në të cilën jeton A.V. vëllai im me familje. Gypin e kam parë me sytë e mi ndërsa hekrat nuk i kam parë sepse ato kanë qenë thellë në ar. Kur i ka vendosur gypin dhe thuprat e hekrit ka qenë përafërsisht para 3 muajve ndërsa datën e saktë nuk e di, me të ardhur nga Zvicra e kishte lajmëruar rastin në Polici. Në dëshminë e këtij dëshmitari, i autorizuari i të paditurit kishte vërejtje.

Baza ligjore

Në bazë të nenit 103 (Posedimi) të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDTS) të Kosovës, parashihet se: “Personi i cili e ushtron pushtetin faktik mbi një send është posedues i drejtëpërdrejtë “.

Në bazë të nenit 104 (Fitimi i posedimit) të LPDTS parashihet se: “Posedimi në një send fitohet me krijimin e pushteti faktik mbi sendin. Marrëveshja e poseduesit të mëparshëm dhe e fituesit të posedimit është e mjaftueshme për fitimin e posedimit, nëse fituesi është në gjendje që të ushtrojë pushtetin mbi sendin në momentin e marrëveshjes.”

Në bazë të nenit 110 (Posedimi pronësor) të LPDTS parashihet se: “Posedimi pronësor Personi i cili e posedon një send që është pronë e tij, është posedues pronësor.”

Në bazë të nenit 111 (Veprimet e kundërligjshme në posedim) të LPDTS parashihet se: “1. Personi i cili e privon nga posedimi poseduesin ose e pengon në posedim kundër vullnetit të poseduesit vepron kundërligjshëm, përveç nëse privimi ose pengimi lejohen shprehimisht me ligj. 2. Posedimi i fituar si rezultat i pengimit të kundërligjshëm është me të metë. Pasardhësi i posedimit tillë duhet të pranojë të metën e posedimit, nëse ai ishte në dijeni për të metën apo ai është trashëgimtar i poseduesit.”

Kurse në bazë të nenit 480 të LPK parashihet se: “Shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë. Përrjashtohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të

drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë ose pandërgjegjshmërinë e posedimit. Përfundohet mundësia që në kontestet për shkak të pengimit të posedimit të parashtrahet kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me anë të veprimeve me të cilat është bërë pengimi i posedimit.”

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në bazë të provave të administruara në këtë procedurë, gjykata ka vërtetuar se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe se e njëjta duhet të refuzohet sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi. Kjo ngase në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, nuk ishte kontestues fakti se sipas matjeve të bëra në terren me dt. 19.12.2023 dhe përpunimit të matjeve në zyrë dhe të dhënave kadastrale, në konstatimin dhe mendimin e ekspertit gjeodet, por poashtu edhe në bazë të daljes në vend shiqim, si dhe dëgjimit të ekspertit gjeodet Dr.sc. M.L. në gjykim (ndaj sqarimeve të cilit palët nuk kishin vërejtje) është pasqyruar gjendja faktike ashtu që në terren e ka gjetur vetëm një shufër metalike (kunj i hekurt) e cila gjendet në pjesën perëndimore përkatësisht përgjatë rrugës publike “W.W.”, gypi prej betoni e ka gjatësinë me diametër prej 1 metri i cili është i vendosur përballë parcelës ...-0-ZK Shtime, gypi prej betoni është i vendosur përgjatë rrugës publike “W.W.” përkatësisht përballë parcelës ...-0-ZK Shtime, në anën perëndimore të parcelës ...-0, kurse shufra metalike është e vendosur brenda parcelës ..-0, përkatësisht në pjesën perëndimore të saj, brenda objektit të kontestit nuk ka hasur elemente tjera, përveç shufrës metalike dhe gypit prej betoni, dyert e hyrjes të cilat janë të vendosura përgjatë rrugës “W.W.” shërbejnë për hyrje nga të cilat i padituri hyn në shtëpinë e vet të ndërtuar brenda parcelës ...-0 si dhe për të hyrë në parcelën ...-0, kurse gjësende tjera në parcelën ...-0 nuk kishte mundur të identifikoj.

Por poashtu në bazë të leximit të deklaratave të dëshmitarëve është konstatuar qartë se dëshmitari M.U., prej vitit 2003 ose 2004 datë saktë nuk e dinë pronën e ka punuar pa pagesë gjegjësisht mbjellur me grurë me leje të babait të paditësit (poashtu dëshmitar në këtë çështje Z.S), edhe investimin edhe rendimentin (fitimet) i kishte marrë vet, armaturat e vendosura nuk i ka parë personalisht me sytë e tij, gurët (sa gurë nuk e din konkretisht) të madhësisë 25 cm mendon se i padituri i ka vendosur në pjesën që i takon sipas marrëveshjes. Poashtu nga deklarata e dëshmitarit Z.M. qartë është konstatuar se në pronën objekt kontesti ka të mbjellë kallamoq të cilën e ka mbjellë M.U., me leje të Z. dhe atë për 24 vite (prej vitit 2000-2001), vetëm M. është duke e shfrytëzuar këtë pronë, poashtu i njëjti deklaron se kurrë nuk ka hyrë në arë dhe as nuk e

din se ku gjendjen kunjat e hekurt dhe as nuk e di kush i ka vendosur ato. Kurse edhe nga deklarimi i dëshmitarit Z.S është konstatuar se para se të i vendos A. (i padituri) kunjët e hekurt në pronë me leje timën këtë pronë e ka shfrytëzuar M. ndërsa pas vendosjes së këtyre gypave prona ka mbetur e pa shfrytëzuar.

Nga të gjitha këto që u konstatuan më lartë, është vërtetuar se mungon lidhja e paditësit (N.S.) me posedimin e fundit faktik të parcelës kadastrale ...-0 ZK Shtime, përkatësisht nga provat e lexuara dhe të administruara në shqyrtimin kryesor të çështjes, nuk u vërtetua se paditësi kishte qenë poseduesi i fundit faktik i parcelës kadastrale kontestuese në mënyrë që i njëjti të gëzon mbrojtje gjyqësore përmes padisë pengim posedimi. Në dispozitën e nenit 480 të LPK përcaktohet shprehimisht që: “Shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë. Përrjashtohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë ose pandërgjegjshmërinë e posedimit”. Kërkesëpadija e paditësit është kontradiktore me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, përderisa nuk ishte kontestuese nga deklaratat e dëshmitarëve se pronën kontestuese e kanë shfrytëzuar përkatësisht mbjellur me lejen e babait të paditësit Z.S, nuk është vërtetuar në mënyrë bindëse dhe të padiskutueshme për këtë gjykatë se paditësi N.S. kishte qenë poseduesi i fundit faktik i pronës, ndërsa në bazë të dispozitave ligjore në fuqi në kontestet e pengim posedimit mbrojtja i jipet (ofrohet) poseduesit të fundit faktik. Në bazë të deklaratave të dëshmitarëve del se poseduesi i fundit faktik ishte M.U. (këtu dëshmitar) i cili paluajtshmërinë e përmendur në padi, e kishte punuar, mbjellur dhe korrur rendimentet e saj, qe shumë vite pa ndërprerë dhe se një veprim të tillë e bënte madje pa patur nevojë as të konsultohet me ndokë tjetër. Dëshmitari M.U., i cili rezulton të jetë daja i paditësit, posedimin e kishte siguruar në mënyrë të bartur nga tani dëshmitari Z.S, përkatësisht babai i paditësit. Dëshmitarët e lartë përmendur nuk ofrojnë dëshmi se ditën kritike e kishin parë paditësin të ishte në posedimin e fundit faktik të sendit (paluajtshmërisë së përshkruar në padi). Në shkresat e lëndës mungojnë dëshmi (përpos pretendimeve deklarative të paditësit) se paditësi ka qenë në posedimin e fundit faktik të parcelës kontestuese, i cili përbën fakt vendimtar në këtë çështje juridiko-civile.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet dhe provat e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktvendimi, duke pasur parasysh se lënda e këtij kontesti është pengim posedimi, e jo vërtetimi i të drejtës së pronësisë apo i ndonjë të drejte të tjetër sendore.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerrur konform nenit 452 dhe 463 të LPK-së dhe tarifës zyrtare të OAK për përfaqësime dhe atë për shpenzimet si në vijim: për përgjigjen në padi shumën prej 104,00€, për katër seanca gjyqësore shumën prej 135,00€ x 4 – 540,00€, respektivisht shuma e tërësishme në lartësi prej 644.00 euro.

Nga se u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e duke u bazuar në nenin 142.3 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Datë 13.02.2024

Gjyqtari,
Armend Ahmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.